

V E N D I M
Nr.502, datë 13.8.1998

PËR FIROT E GRURIT GJATË TRANSPORTIT DETAR DHE SHKARKIMIT NË PORT

Në mbështetje të nenit 36 të ligji nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Normat e firove gjatë transportit detar dhe shkarkimit në port të jenë si vijon:
 - a) gjatë shkarkimit nga anija në peshore deri në 0,9 për qind;
 - b) gjatë transportit nga porti i ngarkimit në atë të shkarkimi deri në 0,8 për qind.
2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë dhe Instituti i Kërkimeve Ushqimore të përfundojnë studimin për firot gjatë transportit detar dhe shkarkimit në port të grurit brenda datës 30.12.1998 dhe ta paraqesin atë për shqyrtim në Këshillin e Ministrave.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano